



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
KRYETARI

Nr. 5348 prot.

Tiranë më 26.06 .2019

URDHËR

Nr. 121 , datë 26.06 2019

MBI ZHVILLIMIN E GJYKIMEVE TË KËRKESAVE PËR “LEJE VOTIMI”

Bazuar në nenin 26 dhe 37 të ligjit nr. 98 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” që përcaktojnë përkatësisht kompetencat e Kryetarit të Gjykatës dhe Zëvendëskryetarit, në nenin 25 që përcakton ndarjen e çështjeve me short si dhe nenin 57 të Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 74 datë 19.07.2012 dhe Ligjin Nr. 31 datë 04.02.2015, për të siguruar një proces normal të gjykimeve të kërkesave me objekt “Lejim votimi”,

URDHËROJ

1. Gjykimi i kërkesave “Leje votimi” do të bëhet nga të gjithë gjyqtarët e Dhomës Civile, me përjashtim të gjyqtarëve të seksionit familjar, si dhe gjyqtarëve të cilëve ju është miratuar paraprakisht leja vjetore nga Kryetari i Gjykatës.
2. Kryesekretaria në respektim të nenit 57 pika 1, i cili citon: “Kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njesisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri **24 orë përpara datës së zgjedhjeve...**”, pranon regjistrimin e kërkesave të paraqitura deri në datën **28.06.2019 ora 24:00**, të cilat do të hidhen në short menjëherë sapo të paraqiten.
3. Shorti i këtyre kërkesave të afishohet në faqen elektronike të Gjykatës: www.gjykatatirana.gov.al, dhe listat në ambientet e jashtme të institucionit.
4. Sipas pikës 3 të nenit 57 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë i cili citon se: “Gjykatat e rretheve gjyqësore shqyrtojnë dhe vendosin në lidhje me kërkesat, sipas pikës 1 të këtij neni, si në ditën e fundit para zgjedhjeve, edhe në ditën e zgjedhjeve, por jo më vonë se **6 orë përpara mbylljes së votimit...**”, gjyqtarët e dhomës civile si dhe administrata gjyqësore do të punojë edhe në ditët e pushimit, konkretisht datë **29 dhe 30 qershor 2019**.
5. Ngarkohet Kancelari dhe Kryesekretaria e dhomës civile të marrin masat për kryerjen e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e këtyre gjykimeve.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
PETRIT ÇOMO

